



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr 67 Datë 24.7.09

PER NJE NDRYSHIM NE VKB NR. 42 DATE 10.04.2009

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hapësinor dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës «Për një ndryshim në VKB nr.42 datë 10.04.2009», bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008, "Për buxhetin e vitit 2009", në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009», VKB nr. 42 datë 10.04.2009 si dhe në VKM nr. 455 datë 23.06.2005 mbështetur në kompetencat që ka si dhe me propozim të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndarjen e fondit prej 90,361,552 lekë në 2 pjesë përkatësisht për objektet:
 1. Rikonstruksion Bulevard Republika në vlerën 83, 609,825 lekë
 2. Restaurim fasadash në vlerën 6, 751,727 lekë
2. Për objektin Rikonstruksion Bulevard Republika në buxhetin e Bashkisë për vitin 2009 nga të ardhurat e Bashkisë janë planifikuar 64, 098,000 lekë, kurse diferenca prej 19, 511,825 lekë do të planifikohet në buxhetin e Bashkisë për vitin 2010. Për objektin Restaurim fasadash vlera prej 6, 751,727 lekë do të planifikohet në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2010.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hapësinor dhe Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës, dhe Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Gjergji Pendavinji